# RAPORTI VJETOR I PLATFORMËS CIVIKOS 2015

platforma CiviKos

www.civikos.net

Platforma CiviKos gjatë vitit 2015 është mbështetur financiarisht nga Komisioni Evropian-Zyra në Kosovë dhe Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung- Zyra në Prishtinë. Po ashtu TACSO Zyra në Kosovë ka përkrahur në mënyrë të vazhdueshme aktivitetet e Platformës CiviKos .

# PËRMBAJTJA


1. Fjala e Drejtores Ekzekutive të Platformës CiviKos....4
2.Hyrje....5
3.Koordinimi i shoqërisë civile rreth zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017....6
4.Zbatimi i Strategjisë Qeveritare Këndvështrimi nga Sekretariati i CiviKos-it....7
5.Objektivi strategjik I – "Pjesëmarrje e siguruar dhe e fuqizuar e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit"....8
6.Objektivi strategjik II- "Sistem i ndërtuar i kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile"....10
7.Objektivi strategjik III – "Sistemi i ndërtuar dhe kritere të përcaktuara për përkrahje financiare për OSHC-të"....11
8.Debat publik- Transparenca dhe llogaridhënia e fondeve publike për organizatat e shoqërisë civile....12
9.Objektivi strategjik IV-"Nxitja e qasjes së integruar në zhvillimin e vullnetarizmit"....13
10. Praktikat e mira nga Rajoni në dobi të zbatitimit të Strategjisë dhe punën e Këshillit....14
11.Fuqizimi i marrëdhënieve me organizatat anëtare dhe jo-anëtare....16
12.Shërbimi informues i Platformës CiviKos ndaj anëtarëve të vet
Shtrirja e vazhdueshme e Platformës CiviKos: Qendrat Rajonale nëpër komuna
Funksionalizimi i Qendrave Rajonale....17
13.Bashkëpunimet me organizatat anëtare
Shfrytëzimi i Sallës së takimeve të CiviKos për organizata anëtare
Sekretariati i Platformës CiviKos prezent në aktivitete dhe ngjarje të organizatave anëtare
CiviKos asiston organizatat anëtare me këshilla financiare dhe....18
14.Pjesëmarrja në panaire dhe ngjarje të ndryshme....19
15.Sekretariati i Platformës CiviKos prezent në konferenca dhe ngjarje të ndryshme ndërkombëtare......20
16.Përzgjedhja e anëtarëve të shoqërisë civile në autoritete publike....22
17.Praktikat e mira të përzgjedhjes së anëtarit të shoqërisë civile shtrihen edhe në nivelin lokal
Kodi Etik i Platformës CiviKos
Reagim ndaj përfaqësimit të shoqërisë civile në Këshillin Prokurorial të Kosovës....23
18.Formimi i grupeve punuese të Platformës CiviKos....24
19.Programi i praktikantëve në Platformën CiviKos....25
20.CiviKos në Medie....26
21.Lista e Anëtarëve të Platformës CIVIKOS....27

# LISTA E AKRONIMEVE

| | | |
|---|---|---|
| **CiviKos** | – | Platforma CiviKos |
| **CNVOS** | – | Qendra për shërbime informuese, bashkëpunim dhe zhvillim të OJQ-ve (Centre for Information Service, Co-operation and Development of NGOs) |
| **OSHC** | – | Organizatë e Shoqërisë Civile |
| **OSBE** | – | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë |
| **KCSF** | – | Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile |
| **KFOS** | – | Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur |
| **GIZ** | – | Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit |
| **ZQM/KM** | – | Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit |
| **ZKM** | – | Zyra e Kryeministrit |
| **Strategjia Qeveritare** | – | Strategjia Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017 |
| **Strategjia e CiviKos** | – | Strategjia e Platformës CiviKos 2015-2017 |
| **Këshilli** | – | Këshilli për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile |

# Fjala e Drejtores Ekzekutive të Platformës CiviKos

Të nderuara organizata anëtare të Platformës CiviKos,
Nga Kuvendi i fundit i Platformës CiviKos në vitin 2014, Kosova është përballur me shumë sfida, kryesisht të ndërlidhura me mos-funksionimin e jetës institucionale në vend. Krizat e njëpasnjëshme kanë pasur një efekt negativ në punën e secilit prej nesh, qoftë në kapacitet individual, të organizatave që përfaqësojmë apo edhe të rrjetit tonë të përbashkët. Megjithatë, nevoja për të ndërvepruar me Qeverinë bazuar në rregulla të paracaktuara jo vetëm që ka mbetur e pranishme në çdo moment, por është shtuar edhe më tepër. Për më tepër, disa rregulla themelore të këtij ndërveprimi – të përcaktuara me Strategjinë qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile – është dashur që të operacionalizohen dhe të fillojnë të prodhojnë rezultate konkrete.

Përgjatë kësaj periudhe, numri i sfidave për CiviKos ka qenë i madh, por edhe më i madh ka qenë numri i rasteve në të cilat i'a ka dalë mbanë që ta shtyjë Qeverinë të ketë qasje të strukturuar ndaj sektorit të shoqërisë civile. Për herë të parë është themeluar një trupë e veçantë dedikuar bashkëpunimit me shoqërinë civile, ndërsa sektori ynë ka shumicën e përfaqësimit nëpërmjet të zgjedhurve të vet me procedura të hapura dhe demokratike. Puna e Këshillit për zbatim të Strategjisë dhe ekipeve të tij vetëm se ka filluar të japë rezultatet e para. Standardet minimale për konsultim publik janë në fazën përfundimtare të hartimit, para se të bëhen standarde të obligueshmë për Qeverinë për përfshirje të publikut në vendim-marrje. Financimi publik për shoqërinë civile së shpejti do të rregullohet ligjërisht bazuar në një model dhe mekanizma konkrete të zbatimit. Përfaqësues të shoqërisë civile në disa trupa qeveritare janë zgjedhur me votat tona. Disa ligje të rëndësishme për shoqërinë civile janë hapur për ndryshim, ndërsa përfaqësues të sektorit tonë janë të përfshirë në këto procese.

Megjithatë, arritjet e mësipërme mund të mbesin të tilla vetëm nëse dokumentet e shkruara fillojnë të zbatohen në praktikë. Një zbatim të tillë nuk e kanë pasur një numër i madh i obligimeve që Qeveria i ka marrë nëpërmjet Strategjisë së bashkëpunimit, siç është rasti me hapjen e sektorit të shërbimeve publike për shoqërinë civile apo nxitjen e punës vullnetare. Ngjashëm, disa raste të suspendimit apo mbylljes jo-ligjore të OJQ-ve nga autoritetet shtetërore e kanë dëshmuar brishtësinë e ambientit në të cilin funksionon sektori ynë.

Angazhimi ynë i deritashëm ka qenë i mjaftueshëm për të përfshirë në agjendën e Qeverisë një numër të madh të çështjeve të rëndësishme për ne, por jo i mjaftueshëm për të siguruar që këto çështje të gjejnë zgjidhjen e duhur. Është në përgjegjësinë e secilës organizatë anëtare që individualisht të kontribuojë në përmirësimin e ambientit në të cilin vepron shoqëria civile, ndërsa bashkërisht të sigurohemi që ky kontribut merret parasysh duke respektuar pritjet dhe rregullat për të cilat jemi dakorduar bashkërisht.

Viti i ardhshëm do të na mundësojë të vlerësojmë nëse angazhimi ynë ka avancuar pozitën e sektorit civil në raport me Qeverinë, apo kemi kontribuar në një dokument tjetër i cili duket bukur, por nuk përkthehet në veprime konkrete. Deri atëherë, mbetet që secili nga ne të rrisë nivelin e angazhimit në kuadër të Platformës CiviKos dhe jo vetëm, për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë e krijuara deri më tani dhe për të hapur rrugë për një presion edhe më të fuqishëm në vitet në vazhdim me qëllim që Qeveria dhe institucionet tjera publike t'a shfrytëzojnë si duhet potencialin e sektorit tonë për zhvillimin e gjithëmbarshëm të shoqërisë dhe shtetit tonë.

***Sinqerisht,***
***Valdete Idrizi***

# Hyrje

## Platforma CiviKos

Platforma CiviKos  është iniciativë e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë që ka për qëllim krijimin e një mjedisi të përshtatshëm formal të bashkëpunimit në mes të sektorit të shoqërisë civile dhe sektorit qeveritar në Kosovë. Që nga themelimi i saj Platforma CiviKos ka qenë e angazhuar që të jetë një zë i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, duke u zotuar që do të jetë një kujdestar i zbatimit të Strategjisë Qeveritare në bazë të parimeve të partneritetit dhe bashkëpunimit dhe krijimit të një ambienti sa më të favorshëm të bashkëpunimit shoqëri civile-qeveri.

## Strategjia e Platformës CiviKos

Platforma CiviKos gjatë 2015-2017 fokusohet në këto objektiva strategjike 1) Fuqizimin e marrëdhënieve me organizatat anëtare dhe jo-anëtare të Platformës CiviKos si dhe portfolio e zgjeruar e shërbimeve 2) Koordinimin e shoqërisë civile për zbatimin e Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe 3) Zhvillimi i dialogut të strukturuar mes shoqërisë civile dhe autoriteteve tjera publike.

## Koordinimi i shoqërisë civile rreth zbatimit të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me shoqërinë civile 2013-2017

Që nga konsolidimi i Këshillit dhe hartimi i Planit të Punës së Strategjisë Qeveritare për vitin 2015, CiviKos ka pasur një rol proaktiv duke koordinuar organizatat e shoqërisë civile në angazhimin e tyre rreth implementimit të Strategjisë, duke punuar ngushtë me Sekretariatin e Këshillit, respektivisht Zyra për Qeverisje të Mirë/ Zyra e Kryeministrit ZQM/ZKM e cila zyre ka mandatin e monitorimit dhe zbatimit të Strategjisë Qeveritare. Në fillim të vitit 2015 pas konstituimit të Këshillit, dhe hartimit të Planit të Punës për 2015, janë formuar edhe ekipet e punës të Këshillit, në bazë të katër objektivave të strategjisë, ku dhe janë përzgjedhur koordinatorët për secilin ekip. Tre nga koordinatorët janë nga shoqëria civile dhe një nga qeveria, ku për grupin I, II dhe IV koordinator janë nga shoqëria civile, ndërsa për grupin e III-të koordinatori është nga qeveria. Deri më tani Këshilli ka mbajtur katër takime të rregullta, të parapara me rregulla të punës së Këshillit. Përveç takimeve të rregullta të këshillit, janë mbajtur takime të vazhdueshme të grupeve të punës për katër objektivat strategjike, të organizuara nga ZQM në bashkëpunim me Sekretariatin e Platformës CiviKos.

### *Monitorimi i zbatimit të Strategjisë nga Sekretariati i Platformës CiviKos*

Sekretariati i Platformës CiviKos përveç koordinimit të anëtarëve të shoqërisë civile në aktivitete rreth zbatimit të strategjisë, poashtu ka monitoruar edhe zbatimin e saj, duke vlerësuar aktivitetet gjatë tërë procesit të zbatimit. Për të lehtësuar këtë proces, me mbështetje të organizatës anëtare Ipko Foundation, Platforma CiviKos ka ndërtuar një Matricë të monitorimit, duke lehtësuar procesin e monitorimit dhe raportimit. Kjo Matricë do t'i shërbejë anëtarëve të Këshillit si një burim i dytë i informatave për të pasë një pasqyrë sa më të mirë rreth zbatimit të Strategjisë.

### *Mbështetje financiare për OSHC-të të përfaqësuara në Këshill*

Përveç koordinimit të OSHC-ve në zbatim të Strategjisë Qeveritare, Sekretariati i Platformës CiviKos në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja, "Duke punuar së bashku. Drejt një marrëdhënie pune produktive mes shoqërisë civile dhe autoriteteve në Kosovë. Faza e Dytë" ofron mbështetje financiare për përfaqësuesit e shoqërisë civile në proceset të cilat lidhen me Strategjinë Qeveritare dhe jo vetëm. Këto grante ofrojnë fonde modeste dhe asistencë teknike për organizatat vendore të shoqërisë civile, të cilat mund të mos kishin qasje në burimet kryesore të fondeve në një mënyrë tjetër. Përqendrimi është në përkrahjen e organizatave të cilat identifikojnë dhe punojnë në çështje të cilat lidhen me bashkëpunimin në mes të shoqërisë civile dhe qeverisë, veçanërisht për implementimin e Strategjisë Qeveritare dhe apo procese të ngjajshme.

# ZBATIMI I STRATEGJISË QEVERITARE KËNDVËSHTRIMI NGA SEKRETARIATI I CIVIKOS-IT

## Objektivi strategjik I – "Pjesëmarrje e siguruar dhe e fuqizuar e shoqërisë civile në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe legjislacionit"

Sa janë OSHC-të anëtare të CiviKos aktive në Konsultime Publike?
Përfshirja aktive e shoqërisë civile dhe qytetarëve në përgjithësi në politik-bërje është vlerë e demokracisë dhe vendimmarrjes. Përfshirja aktive e shoqërisë civile në konsultime publike përveç që ngritë cilësinë e ligjeve, ky proces i bën autoritetet publike më të hapura dhe transparente, dhe në fund do të dalin ligje më të zbatueshme dhe që reflektojnë diversitetin shoqëror. CiviKos përveç shpërndarjes së draft ligjeve për konsultime publike tek anëtarët e vet, në mënyrë të vazhdueshme ka monitoruar pjesëmarrjen e OSHC-ve anëtare në këtë proces, duke koordinuar dhe lehtësuar pjesëmarrjen në grupe të ndryshme të punës që ministritë e ndryshme i krijojnë për hartimin e ligjeve të ndryshme.

Për të parë se sa OSHC-të anëtare të CiviKos janë aktive në procesin e konsultimeve publike që Qeveria e Republikës së Kosovës realizon me OSHC-të kryesisht përmes formës elektronike e po ashtu edhe pjesëmarrjes direkte në grupe punuese në fazat më të hershme të draftimit të ligjeve, Sekretariati i CiviKos-it edhe këtë vit si çdo vit tjetë ka organizuar hulumtim me organizata anëtare. Rezultatet e hulumtimit për vitin 2013-2014 mund t'i gjeni në web faqe përmes vegzës më poshtë: http://www.cikos.net/repository/docs/Analize_pjesemarrja_ne_konsultime_publike_2013_-_2014_211192_354529.pdf

Procesi i konsultimit publik përmes formës elektronike nuk është njëra ndër format më të mira të konsultimit. Të gjeturat nga monitorimi i vazhdueshëm i Sekretariatit tregojnë se në shumicën e rasteve, nuk ka një përgjigje nga personat përgjegjës për konsultimin se a janë marrë parasysh kontributet apo jo, dhe kjo formë nuk siguron përfshirje cilësore të shoqërisë civile në konsultime publike, e në këtë mënyrë e pamundëson argumentin e debatit dhe përfshirjen direkte qysh në fazat më të hershme të konsultimit publik. Për të ndërtuar një sistem sa më gjithëpërfshirës të konsultimit me publikun, Ekipi i punës në kuadër të këshillit, ka punuar ngushtë me Zyrën Ligjore të Zyrës së Kryeministrit, dhe më mbështetje të vazhdueshme të GIZ-it, Zyrës së OSBE-së në Kosovë dhe përfshirjen e OSHC-ve aktive të përfshira në këtë proces, për të vendosë bazën e Standardeve minimale për konsultime publike.

### Vendosja e standardeve minimale për procesin e konsultimeve publike

Procesi i vendosjes së Standardeve Minimale për Konsultime Publike, është proces i cili ka filluar me hartimin e propozim dokumentit për qeverinë me titull "Propozim i Politikave mbi Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik" i hartuar nga organizata KCSF me një konsultim të gjërë me shoqërinë civile në Kosovë.

► Në mars 2015 ky dokument është dorëzuar zyrtarisht tek Zyra e Kryeministrit, si propozim.

►Me qëllim të vendosjes së standardeve minimale për konsultime publike, duke u bazuar në dokumentin e propozuar nga KCSF, Zyra Ligjore/ZKM me mbështetje të Sekretariatit të CiviKos dhe GIZ organizuan punëtorinë e parë të përbashkët, ku u vendosen bazat e para të draft Rregullores për Procesin e Konsultimeve Publike.

► Gjatë muajit Korrik u organizua punëtoria e dytë, në draftimin e kësaj Rregullore, ndërsa në Shtator u mbajt punëtoria e tretë.

► Gjatë muajit tetor janë mbajtur edhe dy punëtori me përfshirje të një numri më të madh të OSHC-ve ku dhe është nxjerrë edhe drafti i parë i Projekt Rregullores për Përcaktimin e Standardeve Minimale për procesin e konsultimit me publikun. Kjo Projekt-Rregullore do të del në konsultim të gjerë me publikun, dhe më pas pritet të miratohet në qeveri në fillim të vitit tjetër.

## Sfidat kryesore

- Vonesat në finalizimin e Rregullorës, si dhe mungesa e analizave me shkrim të legjislacionit në fuqi rreth pjesëmarrjes së OSHC-ve në konsultime publike.
- Përpilimi i një databaze ku identifikohen OJQ-të sipas profileve dhe fushëveprimit të ndryshme është vonuar.
- Identifikimi i nevojave për trajnime për zyrtarët e qeverisë dhe shoqërisë civile edhe pse në proces, është i vonuar.





*Punëtoria për procesin e vendosjes*
*së Standardeve Minimale për Konsultime Publike*



## Objektivi strategjik II - “Sistem i ndërtuar i kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile”.

Qysh nga paslufta në Kosovë OSHC-të kanë ofruar dhe vazhdojnë të ofrojnë shërbime të ndryshme për grupe të ndryshme përfituesish, që shteti nuk i ka ofruar, ose nuk ka pasur kapacitete të mjaftueshme për të mbuluar nevojat e komunitetit. Në vendin tonë OSHC-të kryesisht ofrojnë shërbime sociale siç janë strehimoret për viktimat e dhunës në familje, shërbimet për persona me nevoja të veçanta, etj . Në shumicën e kohës këto organizata që kanë ofruar këto shërbime janë varur nga donacionet e jashtme kryesisht dhe shumë pak janë përkrahur nga shteti, dhe në mungesë të këtyre donacioneve varet edhe funksionimi i këtyre shërbimeve.

Për të pasur një qëndrueshmëri të organizatave që ofrojnë këto shërbime, me Strategjinë Qeveritare është paraparë të krijohet një sistem i qëndrueshëm dhe i pavarur i kontraktimit të shërbimeve nga ana e qeverisë.

### Disa nga aktivitetet dhe sfidat në implementim të kësaj objektive strategjike

► Në shkurt 2015 u konsolidua edhe ekipi i II-të.

► Në maj 2015 me vendim të qeverisë emërohet Ekipi i Përbashkët për Ndërtimin e Sistemit për Kontraktim të Shërbimeve Publike nga OSHC-të i cili grup themelohet për përcaktimin e standardeve dhe parimeve për kontraktim të shërbimeve publike nga OSHC-të. Grupi është i përbërë nga anëtarë të këshillit nga shoqëria civile dhe qeveria.

► Në korrik 2015 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale licencon 11 subjekte Juridike që ofrojnë Shërbime sociale në Kosovë duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për Licencimin të OJQ-ve dhe Subjekteve Private në ofrim të Shërbimeve, i cili konsiderohet si një hap shumë i rëndësishëm drejt një sistemi të mirëfilltë të kontraktimit të shërbimeve.

► Në Tetor 2015- U mbajt takimi i parë i grupit, ku u diskutua rreth zbatimit të Objektivës II-të strategjike. Në Draft Ligjin për Prokurim Publik ka hyrë një nen i veçantë ku përcaktohet kontraktimi i shërbimeve publike për OSHC-të. Për të shmangur konfliktin e interesit mes kompanive dhe OSHC-ve u propozua që të hartohet një ligj i veçantë ku do të përcaktonte kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të.

### Sfidat kryesore

- Krijimi i një sistemi unik të kontraktimit të shërbimeve publike mbetet ende sfidë. Ndryshim plotësimi i ligjit për prokurim publik nuk është i mjaftueshëm për të rregulluar këtë sistem. Nga takimi i grupit të përbashkët të punës u propozua që të hartohet një ligj i veçantë ku do të përcaktonte kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të.
- Ekipi i përbashkët i themeluar me anëtarë nga qeveria dhe shoqëria civile është themeluar me vonesë.
- Mungon analizë specifike e legjislacionit aktual rreth kontraktimit të shërbimeve publike, si dhe mungon komunikimi i mirëfilltë dhe harmonizimi i ministrive me veprimet e strategjisë.



*Sistem i ndërtuar i kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile*

## Objektivi strategjik III – "Sistemi i ndërtuar dhe kritere të përcaktuara për përkrahje financiare për OSHC-të".

Organizatat e shoqërisë civile që nga pas lufta kanë pasur një mbështetje të fuqishme nga donatorët e huaj. Shumica e organizatave kanë ngritur kapacitetet e tyre dhe kanë vazhduar me punën e tyre edhe pas zvogëlimit të fondeve nga donatorët e huaj që përkrahin organizatat e shoqërisë civile në Kosovë, e një pjesë e tyre janë shuar së bashku me largimin e donatorëve të huaj ose kanë minimizuar aktivitetet e tyre. Edhe pse shumicën e punës së tyre organizatat e shoqërisë civile e ofrojnë në mënyrë vullnetare, qëndrueshmëria financiare për funksionim të vazhdueshëm në ofrim të shërbimeve të tyre është shumë i rëndësishëm. Pasi që në Kosovë ende nuk ka skemë nacionale për fonde publike për shoqërinë civile, e në anën tjetër ministritë vazhdojnë të japin fonde OSHC-ve ne forma të ndryshme, Objektiva e III-të e Strategjisë ka për synim krijimin e një skeme nacionale të granteve për shoqërinë civile nga qeveria si dhe përcaktimin e kritereve për të gjitha fondet publike.

### Sfidat kryesore

• Ndër sfidat e kësaj objektive mbetet nisma për hartimin e Ligjit për Filantropi, ku me plan të punës është paraparë të inicohet nga Ministria e Financave. Pas diskutimeve se bartëse e këtij procesi mund të jetë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në fund në Këshill është vendosur që Ministria e Financave të fillojë hartimin e këtij projektligji, mirëpo ende nuk ka fillu nismë konkrete nga kjo ministri. Në anën tjetër ka material e analiza për filantropinë të përgatitura nga OSHC-të tjera.
• Publikimi proaktiv i të gjitha fondeve që ndahen për OJQ-të nga Qeveria e Kosovës mbetet një sfidë dhe kërkesë e Platformës CiviKos.
• Bashkëfinancimin automatik të projekteve të BE-së për OSHC-të nga ana e qeverisë ende nuk ka filluar. Organizata KCSF është ne përfundim të një propozimi për qeverinë e Kosovës rreth bashkëfinancimit automatik i të gjitha projekteve të OSHC-ve që financohen nga BE (sipas përqindjes se përcaktuar nga BE), veprim i paraparë me planin e punës për vitin 2015.

### Disa nga aktivitetet rreth implementimit të kësaj objektive

►Në shkurt është funksionalizuar dhe ekipi i punës së Këshillit për këtë objektivë.
►Në muajin maj u organizua punëtoria e parë për rregullimin e fondeve publike me anëtaret e ekipit të tretë të Këshillit për Zbatim te Strategjisë Qeveritare. Kjo punëtori është organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me Platformën CiviKos dhe përkrahur nga projekti TACSO, Zyra në Kosovë. Gjatë punëtorisë u diskutuan modelet për rregullimin e fondeve publike. Dy modele që u diskutuan ishin: modeli i centralizuar dhe decentralizuar.
►Gjatë dhjetorit do të organizohet punëtoria ku do të vendosen bazat e një sistemi të granteve për shoqërinë civile.
►I paraparë me Planin e Punës për 2015, në korrik është organizuar trajnim për OSHC-të nga Ministria e Integrimit Evropian në bashkëpunim me Sekretariatin e CiviKos për shfrytëzimin e Platformës për Ndihmë të Jashtme. Më shumë se 40 organizata pjesëmarrëse janë pajisur me llogari të veçanta për qasje në këtë platformë. Në të ardhmen varësisht nga nevoja do të kërkohet të organizohen edhe trajnime tjera.

## Debat publik- Transparenca dhe llogaridhënia e fondeve publike për organizatat e shoqërisë civile

Me qëllim të ngritjes së debatit rreth transparencës dhe llogaridhënies në fonde publike Qendra Kulturore dhe Informative e BE-së në bashkëpunim me Sekretariatin e Platformës CiviKos në shtator 2015 kanë organizuar tryezën me temën "Transparenca dhe llogaridhënia e fondeve publike për organizatat e shoqërisë civile". Në panel ishin të ftuar Valdete Idrizi- Platforma CiviKos, Hajrullah Ceku- EC Ma Ndryshe dhe Rexhep Vasolli- Ministria e Financave. Gjatë këtij takimi u përmendën parregullsitë në ndarjen e fondeve publike për OSHC-të, parregullsi këto që adresohen në raportet e auditorit për ministritë e linjës, si dhe sfidat në ndërtimin e një sistemi unik, të pavarur të fondeve publike për OSHC-të.




*Debatohet për parregullsitë në ndarjen e fondeve publike për OSHC-të*



## Objektivi strategjik IV -"Nxitja e qasjes së integruar në zhvillimin e vullnetarizmit".

Vullnetarizmi si praktikë e njerëzve të cilët punojnë dhe angazhohen në veprimtari të caktuara që janë në dobi të përgjithshme të shoqërisë pa qenë të motivuar financiarisht ka qenë e zhvilluar në vendin tonë për një kohë të gjatë e që përveç përfitimit ekonomik që sjellë puna vullnetare po ashtu ndihmon në ngritjen e aktivizimit qytetar, në të mirë të përgjithshme. Vullnetarizmi aktualisht është një fushë e nën-rregulluar në legjislacionin dhe politikat shtetërore të Kosovës. Ligji për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë trajton në mënyrë të përgjithshme vullnetarizmin tek të rinjtë, ndërsa atë e përkufizon si "veprimtari e rinisë e organizuar nga institucioni përkatës, ku të rinjtë vullnetarisht ofrojnë kohën, punën, njohuritë, aftësitë e tyre pa pagesë apo shpërblim, në shërbim të komunitetit, për të mirën e shoqërisë". Ky ligj kufizohet në trajtimin e vullnetarizmit vetëm në moshën 15 – 24 vjeç, duke e lënë të patrajtuar pjesën tjetër të shoqërisë e cila ka një potencial të madh të punës vullnetare. Duke marrë parasysh diversitetin shoqëror, kjo objektivë e Strategjisë Qeveritare synon që fillimisht të analizohet dhe të identifikohen nevojat dhe profili i punës vullnetare në Kosovë, dhe varësisht nga kjo të zhvillohet debati dhe ndërtohet sistemi më adekuat për nevojat specifike të Kosovës.

### Sfidat kryesore

- Mos-harmonizimi i MKRS-së me veprimet e Strategjisë rreth Udhëzimit Administrativ për Vullnetarizmin.
- Vonesa në themelimin e Grupit të përbashkët për vullnetarizëm.
- Mungesa e analizave të mirëfillta në profilin e Vullnetarëve në Kosovë.



*Diskutohen modelet e vullnetarizmit në Kosovë*

### Disa nga aktivitetet rreth implementimit të Objektives IV të Strategjisë

► Gjatë muajit shkurt është funksionalizuar ekipi i punës për këtë objektivë.

► Në muajin Mars, ZQM në bashkëpunim me Sekretariatin e Platformës CiviKos kanë identifikuar organizatat që punojnë në fushën e vullnetarizmit.

► Në Maj, ZQM në bashkëpunim me Sekretariatin e CiviKos organizoi sesion informues me anëtarët e ekipit të IV, dhe OJQ-të tjera nga lista e identifikuar dhe akterë tjerë relevant, ku u diskutuan modelet e vullnetarizmit në Kosovë. Gjatë këtij takimi u kërkua nga Ministria e Kulturës, Rinisë e Sportit që të harmonizon veprimet me strategjinë qeveritare, rreth udhëzimit administrativ për vullnetarizëm, e që kjo kërkesë nuk është përfillur dhe MKRS ka vazhduar punën në atë Udhëzim Administrativ pa konsultim adekuat.

► Në Shtator, anëtarët e Këshillit nga shoqëria civile kanë dërguar listën e përfaqësuesve nga shoqëria civile që do të jenë pjesë e ekipit të përbashkët të punës për zhvillimin e vullnetarizmit në Republikën e Kosovës, ku themelimi i këtij grupi pritet të miratohet nga qeveria.

## Praktikat e mira nga Rajoni në dobi të zbatitimit të Strategjisë dhe punën e Këshillit

Sekretariati i Platformës CiviKos në bashkëpunim me partnerët nga Rajoni ka organizuar disa punëtori dhe ngjarje të ndryshme duke sjellë përvojat e mira të shteteve të rajonit rreth bashkëpunimit shoqëri civile-qeveri.
Disa nga punëtoritë dhe ngjarjet e organizuara gjatë vitit:






Gjatë muajit mars, Sekretariati i Platformës CiviKos në bashkëpunim me organizatën partnere nga Slovenia CNVOS organizuan punëtori me anëtarët e ekipeve punuese të Këshillit. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte identifikimi i nevojave potenciale të grupeve të punës së këshillit për mbështetje të jashtme, shkëmbimi i përvojave nga Sllovenia dhe rajoni i Ballkanit Perëndimor të ofruar nga rrjeti CNVOS, si dhe ndërtimi i një kuptimi të përbashkët rreth detyrave në planin e punës së këshillit. Në kuadër të këtij takimi u zhvilluan edhe punëtori të përbashkëta për katër objektivat strategjike. Në trajnim morën pjesë anëtarët e ekipeve të punës nga shoqëria civile dhe qeveria.

Në Qershor, Sekretariati i Platformës CiviKos në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë, kanë organizuar në Prishtinë punëtori dy ditore me përfaqësues nga Zyra për Bashkëpunim me shoqërinë civile në Kroaci dhe përfaqësues tç shoqërisë civile të Këshillin Kroat për zhvillim të shoqërisë civile. Përfaqësuesit nga Kroacia prezantuan praktikat e mira dhe sfidat në implementim të strategjisë në Kroaci, e në veçanti sfidat në zbatimin e strategjisë së parë për shoqërinë civile e poashtu edhe fazat tjera. Në ditën e dytë punëtoria u mbajt vetëm me anëtarët e shoqërisë civile të përfaqësuar në Këshill, ku u diskutuan praktikat e mira në bashkëpunimin shoqëri civile- qeveri (modeli kroat), mobiizimi i shoqërisë civile, sfidat e zbatimit të strategjisë ne Kosovë, si dhe zhvillimi i mekanizmave të kontrollit për monitorimin e zbatimit të Strategjisë- hap pas hapi.











Në Korrik 2015 në Qendrën Kulturore dhe Informative të BE-së në Prishtinë Sekretariati i Platformës CiviKos në bashkëpunim me përfaqësuesit nga organizata partnere CNVOS organizuan sesion të përbashkët informues më përfaqësues të Këshillit për Zbatim të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe Ekipeve të Punës të Platformës CiviKos. Qëllimi i këtij sesioni ishte ndërtimi i një kuptimi të përbashkët mbi rolin dhe përgjegjësitë e përfaqësuesve të OSHC-ve në Këshill, si dhe komunikimi dhe ndërlidhja e punës së Këshillit me ekipet e punës të Platformës CiviKos si dhe organizatat tjera në Kosovë.

## Ndër sfidat kryesore të zbatimit të Strategjisë respektivisht planit të punës për vitin 2015 kanë qenë:

- Vonesa në zbatim të veprimeve të parapara me Planin e Punës për vitin 2015 për katër objektivat strategjike.
- Mos ndarja e buxhetit nga ana e qeverisë për implementim të Strategjisë.
- Mos koordinim i ministrive të linjës rreth harmonizimit të veprimeve të tyre në implementim të Strategjisë.
- Sistemi i monitorimit, dhe raportimit të Implementimit të Strategjisë nga ana e ZQM, është krijuar me vonesë.
- Mungesa e kapaciteteve tek Institucionet për zbatim të strategjisë

# FUQIZIMI I MARRËDHËNIEVE ME ORGANIZATAT ANËTARE DHE JO-ANËTARE

## Shërbimi informues i Platformës CiviKos ndaj anëtarëve të vet

Në linjë me misionin e vet dhe Strategjinë e CiviKos-it, Sekretariati i CiviKos ka vazhduar me qasje pro-aktive ndaj anëtarëve të saj. Përveç koordinimit në bashkëpunimin shoqëri civile-qeveri, Sekretariati i CiviKos-it në mënyrë të vazhdueshme ka shpërndarë informata të vlefshme për anëtarë të cilat informata janë të ndërlidhura me bashkëpunimin shoqëri civile – institucione, informata në fusha tjera që janë relevante për shoqërinë civile si: mundësi për grante, mundësi pjesëmarrjeje në konferenca të ndryshme, vizita studimore, programe edukative, trajnime të ndryshme etj. Gjatë vitit 2015 janë dërguar rreth 100 njoftime. Për të rritur vizibilitetin dhe për të qenë sa më afër nevojave të anëtarëve, Sekretariati i CiviKos ka ridizajnuar web-faqën e saj www.civikos.net. Krahas ri-dizajnimit të web faqes është lëshuar edhe shërbimi E-newsletter ku të gjithë të interesuarit për të pranuar informata në baza dy javore kanë pas mundësi të regjistrohen për këtë shërbim në këtë faqe. Aktualisht më shumë se 300 e-mail adresa janë të regjistruara në këtë sistem.
CiviKos ka vazhduar në mënyrë të vazhdueshme të promovojë ngjarjet dhe aktivitetet e ndryshme të organizatave anëtare duke shfrytëzuar shërbimin informues, web faqën e CiviKos dhe rrjetet sociale. Edhe interesimi për anëtarësim në Platformën CiviKos nuk ka munguar. Aktualisht në Platformën CiviKos janë 168 organizata anëtare dhe një numër në pritje të anëtarësimit formal.

## Shtrirja e vazhdueshme e Platformës CiviKos: Qendrat Rajonale nëpër komuna

Për të qenë sa më afër organizatave që operojnë në nivelin lokal në tërë Kosovën, Sekretariati i Platformës CiviKos në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja, ka filluar me 5 Qendra Rajonale nëpër qytetet kryesore të Kosovës. Organizatat e përzgjedhura sipas komunave që shërbejnë si qendra rajonale janë: OJQ INPO- Ferizaj, Network of Peace Movement (NOPM) – Kamenicë, Community Building Mitrovica (CBM)- Mitrovicë, Syri i Vizionit – Pejë, dhe OJQ Dora Dorës në Prizren. Këto qendra në fazën e parë do të ofrojnë komunikim (reagim) dhe informim mbi procesin e përgjithshëm të pjesëmarrjes civile, partneritet specifik, si dhe dialog, bashkëpunim dhe konsultime të tjera të udhëhequra nga CiviKos-i ose nga OSHC-të tjera që janë mbështetur nga Platforma CiviKos, në regjionet e tyre, duke përfshirë edhe organizatat që nuk janë anëtare në Platformën CiviKos dhe për të rritë bashkëpunimin.

## Funksionalizimi i Qendrave Rajonale

Pas përzgjedhjes së organizatave që do të shërbejnë si qendra rajonale të CiviKos në Korrik, Platforma CiviKos në bashkëpunim me organizatën partnere nga Slovenia CNVOS organizoi trajnim me të gjithë koordinatorët e Qendrave Rajonale.
Gjatë muajit nëntor, Qendrat Rajonale të CiviKos organizuan takime informuese me fokus grupet e shoqërisë civile që veprojnë në këto komuna, ku u diskutua rreth vlerësimit të nevojave të OJQ-ve në secilin rajon specifikisht. Disa nga sfidat kyçe të identifikuara nga vet organizatat, për të punuar me organizatat në nivelin lokal janë:

- *Mungesa e fondeve për shoqërinë civile;*
- *Mungesa e rrjeteve avokuese të OJQ-ve që veprojnë në nivelin lokal;*
- *Afërsia e disa OJQ-ve me pushtetin dhe politiken dhe shfrytëzimi i këtyre OJQ-ve, për arritjen e qëllimeve politike;*
- *Mungesa e trajnimeve në ngritjen e kapaciteteve të OJQ-ve;*
- *Mungesa e profilizimit të OJQ-ve që veprojnë në komuna.*

Këto takime të organizuara nga Platforma CiviKos i kanë paraprirë planifikimit strategjik që është mbajtur me datë 7 dhe 8 Dhjetor në bashkëpunim me organizatën partnere CNVOS, e në këtë mënyrë CiviKos bashkë me qendrat rajonale avokojnë për fonde dhe partneritete bazuar në objektivat strategjike të përbashkëta.

## Bashkëpunimet me organizatat anëtare

Platforma Civikos ka vazhduar të bashkëpunojë me organizatat anëtare në forma dhe projekte të ndryshme. Një bashkëpunim që vlen të theksohet është me organizatën Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) në hulumtimin: Siguria e punës në Organizatat e Shoqërisë Civile: Zbatimi i Legjislacionit të Punës.
Sekretariati i CiviKos-it ka ndihmuar organizatën QKSS në realizimin e hulumtimit me titull Siguria e punës në Organizatat e Shoqërisë Civile: Zbatimi i Legjislacionit të Punës, duke ndihmuar në përpilimin e pyetësorit, shpërndarjen tek organizatat anëtare dhe koordinimin e OSHC-ve anëtare në takimet e fokus grupeve. E më pas edhe në prezantimin e të gjeturave të hulumtimit. "Siguria e punës në Organizatat e Shoqërisë Civile: Zbatimi i Legjislacionit të Punës", realizuar nga Qendra Kosova për Studime të Sigurisë (QKSS) në Qendrën Informative dhe Kulturore të Be-së ku prezantoi rreth implementimit të Strategjisë Qeveritare, më konkretisht objektiva 3: Sistem i ndërtuar dhe kritere të përcaktuara për përkrahje financiare për OSHC-të në Kosovë.

## Shfrytëzimi i Sallës së takimeve të CiviKos për organizata anëtare

CiviKos ka vazhduar të ofrojë dhe asistojë organizatat anëtare duke u ofruar sallën e takimeve pa pagesë. Gjatë vitit 2015 rreth 20 organizata anëtare kanë shfrytëzuar hapësirat e CiviKos për aktivitetet e tyre. CiviKos inkurajon organizatat anëtare që të vazhdojnë shfrytëzimin e aseteve të Platformës CiviKos kurdo që kanë nevojë.

## Sekretariati i Platformës CiviKos prezent në aktivitete dhe ngjarje të organizatave anëtare

Sekretariati i Platformës Civikos ka vazhduar të jetë prezent në aktivitete dhe ngjarje që organizatat anëtare kanë organizuar gjatë tërë vitit. Sekretariati i Platformës CiviKos ka qenë prezent në më shumë se 70 ngjarje dhe aktivitete të ndryshme të organizatave anëtare gjatë këtij viti në të gjitha qendrat e Kosovës.

## CiviKos asiston organizatat anëtare me këshilla financiare dhe organizative

